

VENDIM
Nr.655, datë 25.9.2003

PËR KRIJIMIN E QENDRËS SË TRAJNIMIT DHE TË KUALIFIKIMIT PËR ARSIMIN
(QTKA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 121 dhe 124 të ligjit nr.8485 datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për arsimin parauniversitar" dhe të nenit 8 të ligjit nr.8993, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Qendrës së Trajnimit dhe të Kualifikimit për Arsimin (QTKA), si institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, me objekt kryesor trajnimin dhe kualifikimin e mësuesve dhe të drejtuesve të institucioneve shkollore parauniversitare.

2. Struktura dhe organika e QTKA-së miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës.

3. Ministri i Arsimit dhe i Shkencës miraton rregulloren e funksionimit të QTKA-së.

4. Drejtuesit e QTKA-së (drejtori dhe kancelari) emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për emërimin, lirin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit".

5. Nëpunësit e QTKA-së (përgjegjës sektori, specialistë) emërohen pas një procesi konkurrues, në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

6. Pagat e drejtuesve dhe të nëpunësve të QTKA-së caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Numri i punonjësve të QTKA-së të jetë brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

8. Për punonjësit, që, pas riorganizimit, rezultojnë pa vende pune, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano